

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. _____ prot

Datë 06.01.2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: **Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) “Jehona Soft” SHPK, NUIS: M11411005H , 80%, adresa: Tiranë ,Rruga Petrela, Objekti/Pallati Marga 2, kati 7, Apartamenti 702, Tirane, Shqiperi 1016 & “Prisma” SHPK, NUIS: M22121029F , 20%, adresa: Tiranë Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5,Tiranë.**

Tipi i Kontratës: **Kontratës Publike për shërbime**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-65394-10-16-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës [*Objekti, sasitë dhe kohëzgjatja e kontratës*]: **“Blerje shërbim për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e sistemit të faturimit AL-Billing, sistemit WAMR, SQL server oracle data base, OMEGA CORE AUDIT”, me kohëzgjatje 24 muaj duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **17.10.2025.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike : **Nr. 61 datë 20 Tetor 2025.**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **x** ☒

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. “KREATX” SHPK, NUIS: L12121023B, vlera:: 6.956.800 (gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind) lekë.
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “Jehona Soft” SHPK, NUIS: M11411005H , 80% & “Prisma” SHPK, NUIS: M22121029F , 20%, vlera: 8.895.000 (tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1."KREATX" SHPK, NUIS: L12121023B

Për arsyet e mëposhtme:

- Lidhur me operatorin ekonomik "KREATX" Sh.p.k, KVO unanimisht vendosi: Rezulton se ky operator nuk plotëson disa nga kriteret kualifikuese të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht kriteret 3.3 dhe 3.4, siç janë përcaktuar tek Procesverbal tip i kontrates shërbim për kriteret e kualifikimit, konkretisht:

1. Mosplotësimi i kriterit 3.3 – Autorizimi i prodhuesit / kontrata e bashkëpunimit
Sipas këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të prodhuesit/autorit/distributorit të autorizuar ose kontratë bashkëpunimi për objektin e prokurimit, përkatësisht për Programin Kompjuterik “Al-Billing” dhe Sistemin “Omega Core Audit” të bazës së të dhënave.

Aktualisht, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë (SHRUKK) përdor: Sistemin e faturimit Al-Billing dhe Sistemin Omega Core Audit, Operatori ekonomik KREATX ka paraqitur autorizime për programe të tjera, konkretisht FlareBilling dhe Mobiread. Këto autorizime nuk përmbushin kete kriter, pasi në kriteret e kualifikimit është përcaktuar qartë detyrimi për paraqitjen e autorizimeve ose kontratave të bashkëpunimit për sistemet specifike Al-Billing dhe Omega Core Audit,jo ekuivalente me keto sisteme/programe. Infrastruktura e SHRUKK Korçë është e ndërtuar dhe funksionon mbi këto sisteme ekzistuese dhe objekti i prokurimit ka për qëllim mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, dhe jo implementimin apo zëvendësimin e saj.

Gjithashtu nga koorespondenca me autorin e programit AlBilling rezulton qe operatori juaj te mos jete i pajisur me autorizim për zhvillimin dhe mirembajtjen e sistemit AlBilling.

2. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga Operatori Ekonomik KREATX rezulton se nuk janë paraqitur punonjës të certifikuar për zhvillim dhe mirëmbajtje të Programit Kompjuterik Al-Billing, si dhe nuk janë paraqitur punonjës të certifikuar për mirëmbajtjen e Sistemit Omega Core Audit. Punonjesit e certifikuar për programin Kompjuterik Al-Billing dhe Sistemit Omega Core Audit jane kriteret te kerkuara nga AK dhe për pasojë operatorin ekonomik nuk i ka përmbushur, ne keto kushte shprehemi se

operatorit ekonomik i mungon kapaciteti teknik minimal i kërkuar për realizimin e objektit të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton që operatori ekonomik të ketë dorezuar certifikime për sistemet ekuivalente dhe jo për sistemet e kërkuara nga AK.

Bazuar në sa më sipër, konstatohet se Operatori Ekonomik KREATX nuk plotëson kriterin kualifikues 3.3, për shkak të mungesës së autorizimit ose kontratës së bashkëpunimit për sistemet Al-Billing dhe Omega Core Audit, si dhe nuk plotëson kriterin kualifikues 3.4, për shkak të mungesës së personelit teknik të certifikuar për këto sisteme kritere këto të kërkuara tek procesverbali i kritereve të kualifikimit.

Si rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk është në përputhje me kërkesat teknike dhe ligjore të Autoritetit Kontraktor dhe oferta nuk mund të konsiderohet e kualifikuar.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) “Jehona Soft” SHPK, adresa: Tiranë ,Rruga Petrela, Objekti/Pallati Marga 2, kati 7, Apartamenti 702, Tirane, Shqiperi 1016 & “Prisma” SHPK, adresa: Tiranë Kompleksi KIKA 2, Rruga “Tish Daija”, kati i dytë, godina Nr.7, njësia Bashkiake Nr.5,Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 8.895.000 (tetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë është identifikuar si ofertues i sukseshëm.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor

Frosela Filo